



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

**RREGULLORE (P) NR. 01/2017
PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË SHITËSISË NGA
PRESIDENTI PËR INTERES TË VEÇANTË TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

Prishtinë, 19.05.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 dhe nenit 14 (7) të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), duke marrë parasysh kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e shtetësisë në interes të veçantë të përcaktuara në nenin 10 (3) të Ligjit Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 33, 02 shtator 2013), duke marrë parasysh propozimin e Sekretarit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me nenin 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016),
nxjerr:

RREGULLORE (P) NR. 01/2017
PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË SHETËSISË NGA PRESIDENTI
PËR INTERES TË VEÇANTË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurën për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës me Dekret të Presidentit, për personin e huaj të moshës madhore, në interes të veçantë ekonomik, social, kulturor, sportiv, shkencor, politik apo profesional të Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit, për të gjitha kërkesat drejtuar Presidentit për fitimin e shtetësisë.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Departamenti** – nënkupton Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.2. **Fitimi i shtetësisë** – nënkupton fitimin e shtetësisë, që e jep Presidenti me Dekret, në interes të veçantë ekonomik, social, kulturor, sportiv, shkencor, politik apo profesional të Republikës së Kosovës;
 - 1.3. **Institucionet përkatëse** - Institucionet shtetërore, komunale, OJQ ose institucionet private që mund të kenë të dhëna për personin e huaj që ka kërkuar fitimin e shtetësisë;
 - 1.4. **Interes i Veçantë** – nënkupton interesin ekonomik, social, kulturor, sportiv, shkencor, politik apo profesional të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. **Kërkesë** – nënkupton kërkesën për fitim të shtetësisë nga personi i huaj;
 - 1.6. **Ligj** – nënkupton Ligjin Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 33, 2 Shtator 2013);
 - 1.7. **Ministria** – nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme;
 - 1.8. **Mosha madhore** – nënkupton personin mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.
 - 1.9. **Person** – nënkupton personin fizik;
 - 1.10. **Person i huaj** – nënkupton çdo person i moshës madhore i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.11. **President** – nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.12. **Sekretari** – nënkupton Sekretarin e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.13. **Shtetësi** – nënkupton një lidhje të ngushtë juridike midis shtetit të Republikës së Kosovës dhe një personi nga e cila rezultojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella;
 - 1.14. **Zyra** – nënkupton Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI II - PROCEDURA E FITIMIT TË SHTETËSISË

Neni 4 **Kërkesa për fitimin e shtetësisë**

1. Çdo person i huaj mund të paraqet kërkesë për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, e cila duhet:
 - 1.1. t'i drejtohet Presidentit;
 - 1.2. të përmbajë arsyet dhe motivet që ndërlidhen me interes të veçantë;
 - 1.3. të jetë e nënshkruar.
2. Kërkesa dërgohet në Zyrë apo në përfaqësinë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

3. Nëse kërkesa dërgohet në përfaqësinë diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës, e njëjta kërkesë duhet që brenda afatit tridhjetë (30) ditor të dërgohet në Zyrë, nga Shefi i Misionit Diplomatik apo Konsullor.

Neni 5

Dokumentet e kërkesës për fitimin e shtetësisë

1. Kërkesës për fitimin e shtetësisë, i bashkangjeten dokumentet, në vijim:
 - 1.1. certifikata e lindjes apo dokument tjetër i barasvlefshëm;
 - 1.2. kopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm me fotografi, që duket qartë;
 - 1.3. dëshmi që nuk është nën hetime penale dhe që nuk është i dënuar për vepra penale jo më tepër se gjashtë (6) muaj, e lëshuar nga organet kompetente në vendin ku është shtetas;
 - 1.4. dokument tjetër që parashtruesi i kërkesës e konsideron të nevojshëm.
2. Në rastet kur kërkesës për fitimin e shtetësisë i bashkëngjiten shkresa përkrahëse nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, shkresa duhet të jetë e nënshkruar nga titullari i institucionit përkatës.

Neni 6

Shqyrtimi i kërkesës

1. Të gjitha kërkesat për fitimin e shtetësisë, që i drejtohen Presidentit, i përcillen Departamentit për procedurë të mëtejshme, nëse Presidenti nuk vendos ndryshe.
2. Departamenti shqyrton të gjitha dokumentet e dorëzuara për fitimin e shtetësisë nga paraqitësi i kërkesës dhe vlerëson nëse dokumentet e dorëzuara i përmbushin kriteret përkatëse për procedim të mëtejshëm.
3. Nëse kërkesa nuk është e plotë, Departamenti kërkon nga paraqitësi i kërkesës të bëjë plotësimin.
4. Nëse kërkesa bëhet nga subjektet që nuk kanë të drejtë të paraqesin kërkesë, Departamenti e udhëzon paraqitësin për procedurat ligjore në fuqi.

Neni 7

Kërkesa për informata plotësuese nga institucionet përkatëse

1. Departamenti pasi shqyrton kërkesën, kërkon informata plotësuese nga institucionet përkatëse dhe të sigurisë me qëllim të plotësimit të të dhënave për personin e huaj që ka kërkuar fitimin e shtetësisë dhe verifikimin se a ka ndonjë pengesë ligjore për fitimin e shtetësisë, gjegjësisht nëse personi i huaj ka qenë i dënuar për veprë penale brenda ose jashtë Republikës së Kosovës ose nëse dhënia e shtetësisë është në kundërshtim me interesat e Republikës së Kosovës.
2. Siç është përcaktuar në Nenin 9 të Ligjit, askush nuk mund të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës, nëse është i dënuar për veprë penale brenda ose jashtë Republikës së Kosovës ose

nëse dhënia e shtetësisë është në kundërshtim me interesat e Republikës së Kosovës, në veçanti me ato të sigurisë së brendshme dhe të jashtme ose të marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Dënimi për vepër penale në kuptimin e këtij paragrafi nuk përfshin dënimet e përcaktuara në Nenin 9 (4) të Ligjit.

Neni 8

Opinionit i Departamentit

Pas pranimit të informatave plotësuese nga institucionet përkatëse për personin e huaj që ka kërkuar fitimin e shtetësisë, Departamenti përgatit opinion ligjor për Presidentin.

KAPITULLI III – DEKRETI I PRESIDENTIT PËR DHËNIEN E SHTETËSISË

Neni 9

Dekreti i Presidentit

1. Dhënia apo mosdhënia e shtetësisë është e drejtë e Presidentit, pavarësisht dispozitave të kësaj rregullore apo opinionit të Departamentit.
2. Në rastet kur Presidenti vendos t'i jep shtetësinë e Republikës së Kosovë një personi të huaj, Departamenti përgatit Propozim Dekretin.
3. Dekreti i Presidentit për dhënie të shtetësisë përmban por nuk kufizohet në përdorimin e të dhënave për personin e huaj që fiton shtetësinë, shkurtësën “DSH”, numrin, datën dhe vitin e lëshimit (Shtojca Nr.1).
4. Dekretin për dhënie të shtetësisë, Zyra ia dërgon personit të huaj i cili fiton shtetësinë dhe një kopje identike Ministrisë.
5. Personi i huaj pas pranimit të Dekretit për fitimin e shtetësisë, mund të fillojë procedurën e regjistrimit në Zyrën përkatëse të Gjendjes Civile.

Neni 10

Konfidencialiteti

Zyrtarët e autorizuar gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave për fitimin e shtetësisë, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave.

Neni 11

Regjistri i personave që kanë fituar shtetësinë me Dekret të Presidentit

1. Departamenti, mban Regjistrin për personat që kanë fituar shtetësinë me Dekret të Presidentit.

2. Drejtori i Departamentit për Çështje Juridike cakton zyrtarin përkatës ligjor i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij Neni.

KAPITULLI IV- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12 Bashkëpunimi

1. Departamenti bashkëpunon me institucionet përkatëse për rregullimin sa më të mirë të procesit të mbledhjes së dëshmive për dhënien e shtetësisë në interes të veçantë.

3. Departamenti mund të lidh Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse në zbatim të paragrafit një (1) të këtij Neni.

Neni 13 Shtojca

Pjesë e kësaj rregulloreje është shtojca një (1) – Forma e Dekretit për dhënien e shtetësisë.

Neni 14 Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Procedurën e Shqyrtimit të Kërkesave për Shtetësinë e Republikës së Kosovës (Prot: 219, 24.03.2016).

Neni 15 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas nënshkrimit nga Presidenti.

Hashim THAÇI,
President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 19.05.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

DEKRET PËR DHËNIEN E SHETËSISË

Nr. i Dekretit: DSH-(numri i radhës) – (viti).

Presidenti i Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 84 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), nenit 10 (3) të Ligjit Nr. 04/L-215, për Shtetësinë e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 33, 2 shtator 2013), nenit 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), nenit 9 të Rregullores (P) Nr.01/2017 për procedurën e dhënies së shtetësisë nga Presidenti për interes të veçantë të Republikës së Kosovës, si dhe duke marr parasysh kërkesën për fitimin e shtetësisë të Znj/Z. (emri mbiemri), (Nr. prot.: XXX), të datës _____.____.____,
nxjerr:

D E K R E T

1. Znj/Z. (emri mbiemri), i/e lindur më _____. _____.____, në (vendi i lindjes), i jepet shtetësia e Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës të ndërmerr hapat e mëtejme për zbatimin e këtij dekreti në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ky Dekret hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më _____. _____. ____